VENDIM
Nr. 824, datë 5.12.2007

PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

(Ndryshuar me VKM nr. 345, datë 8.4.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Universitetin Politeknik të Tiranës:

a) Krijohet Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili të ketë në përbërje:

- Qendrën e Kërkimit dhe Zhvillimit në Teknologjitë e Informacionit, (INIMA);
- Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, që krijohet nga ndarja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike, ish-pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;
- Departamentin e Inxhinierisë Informatike, që kriojohet nga ndarja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike, ish-pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;
- Seksionin e Informatikës, ish-pjesë e Departamentit të Matematikës dhe Informatikës, në varësi të rektoratit.

b) *Krijohet Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, që ka në përbërje:*

i) Departamentin e Inxhinierisë Matematike;

ii) Departamentin e Inxhinierisë Fizike;

iii) Departamentin e Kimisë;

iv) Qendrën e Gjuhëve të Huaja.

c) Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike riorganizohet dhe ka këto departamente:

- Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë;
- Departamentin e Elektroteknikës;
- Departamentin e Automatikës.

2. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike do të ofrojnë të njëjtat programe studimi, në të tri ciklet, që ofronte Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, të ndara sipas disiplinave përkatëse, struktura e të cilave përcaktohet nga vetë institucioni. Programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë do të riorganizohen sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe për vitin akademik 2008-2009 do të ofrohen, pasi të miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

3. *Shfuqizuar.*

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha